



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 356, datë 03.11.2021

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR PROKURORË PRANË  
PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË  
ORGANIZUAR TË CILËT PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 7 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenin 47/1/b dhe 48/1 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar si dhe në nenin 12 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Posaçëm,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e listës me emrat e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë pas vlerësimit paraprak, sipas rendit alfabetik më poshtë;
  1. Alfred SHEHU
  2. Elvin Gokaj
  3. Sonila Muhametaj (Domi)
2. Relacioni shoqërues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Kandidatët e listuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të vazhdojnë garën e mëtejshme për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
MOISI DUDA

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ